

Data 25.08.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

90610000-6 - Shërbimet pastrimi dhe fshirjeje të rrugëve, 90611000-3 - Shërbime të pastrimit të rrugëve.

VLERA E FONDIT LIMIT:

550,395,505 (pesëqind e pesëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesë) **lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavajë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë referuar nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Kërkesa për paraqitjen e xhiros së tre viteve të fundit financiare, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite që mund të jenë jo të sukseshme financiarisht, por me kohështrirje tre vjecare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretisht niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2019, 2020 dhe 2021 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenin 26 të VKM nr.285 dt.19.05.2021.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten kontrata e shërbimit, vërtetim i realizimit me sukses i lëshuar për të njëjtën kontratë dhe faturën tatimore të shitjes (situacionet), ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes (situacionet), ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.2. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

1. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me deklaratë të vecantë Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit, me eksperiencë pune mbi 5 vjet dhe i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Qershor – Gusht 2022. Dokumentacioni i nevojshëm për të provuar këtë është kontratë pune e vlefshme, librezja e punës, diploma, CV, çertifikatë e lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
2. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu kontratë pune të vlefshme, diplomë/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/ licencuar/ certifikuar shqiptar ose i huaj dhe CV për 1(një) inxhinier mjedisi ose 1 ekspert në fushën e mjedisit.
3. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar/certifikuar shqiptar ose i huaj për 1(një) ekspert i specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

4. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë përkatëse për 1 (një) ekspert specialist në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit me me eksperiencë pune mbi 5 vjet. Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë të drejtuesit teknik të këtij shërbimi. Kriteri I mesipërme për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Përvoja 5-vjecare lidhet ngushtë me afatin e realizimit të objektit të prokurimit, tregon aftësitë menaxhuese të drejtuesit teknik për kontratë afatgjatë.

Kërkesa për 1(një) inxhinier mjedisi ose 1 ekspert në fushën e mjedisit lidhet ngushtë me natyrën e shërbimeve objekti i prokurimit.

Kërkesa për një punonjës të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” bazohet në kërkesat e Ligjit Nr.10 237, dt 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”

2.3.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe CV për një mjek të përgjithshëm.

Argumentim: Kërkesa për e mesipërme është detyrim ligjor bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, i ndryshuar me VKM nr. 632, datë 15.07.2015. Referuar akteve ligjore të mesipërme Inspektoriatit Shtetëror të Punës sqaron që pavarësisht përcaktimeve të pikës 6 të VKM Nr. 632, datë 15.7.2015, çdo subjekt duhet të ketë mjekun e shoqërisë pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve. <https://inspektoriatipunes.gov.al/sherbimet-e-mjekesise-se-punes/>

2.3.4. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë:

- a. kontratë pune të vlefshme dhe diplomë për 1(një) inxhinier mekanik me eksperiencë pune mbi 5 vjet. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga QKL kodi III.1.A (riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave).

ose

- b. Kontratë e vlefshme shërbimi me një subjekt tjetër i cili duhet të ketë objekt të veprimtarisë së tij riparimit të mjeteve motorrike. Të paraqitet, për të provuar këtë kusht, kontratë e vlefshme shërbimi dhe leje të lëshuar nga QKL kodi III.1.A (riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura (“a” ose “b”) e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 /b/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me anë të këtij

kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion nw kushte optimale teknike mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, e cila bwhet e mundur nwpwrmjet asistencws teknike qw operatori ekonomik ka nw stafin e tij ose nwpwrmjet kontratave qw ky i fundit nwnshkruan me tw tretwt. Eksperienca 5-vjecare e inxhinierit mekanik wshtw domosdoshmwri qw lidhet me tipin e mjeteve (makineri teknologjike) qw nevojiten pwr realizimin e objektit te kontratws dhe nw raport me afatin e kontratws. Megjithatw operatorwt ekonomikw kanw mundwsinw qw pwr pwrmbushjen e kwsaj kwrkese tw lidhin kontratw shwrbimi me shoqwri qw ushtrojnw vprimtari riparimi tw mjeteve motorrike. Kërkesa pwr lejet lëshuar nga QKL është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, të mjedisit dhe shëndeteti të sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.3.5. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme
2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente dhe e vlefshme
3. ISO 39001 (Standard per sistemin e menaxhimit te sigurise rrugore)/ekuivalente dhe e vlefshme

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, të mjedisit dhe shëndeteti të sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.3.6. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 70 (shtatëdhjetë) punonjës për periudhën Qershor – Gusht 2022, i lëshuar nga Administrata Tatimore.
2. Listpagesat, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore, për periudhën Qershor – Gusht 2022.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar nw proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer nevojiten, si mw poshtw:

1. Shofere 10 persona, 7 shoferw tw domosdoshwm pwr drejtimin e mjeteve teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor dhe 3 shoferw pwr drejtimin e 6 mjeteve tw tjera teknologjike, tw cilat kryejnw procese shwrbimi jo ditor.
2. Pwr afrimin e kontenierwve pranw mjeteve teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor duhen pwr secilin mjet 2 persona, nw total 14 persona.
3. Punwtorw pwr fshirjen e shesheve janw 32 persona nw Kavajw dhe 14 persona nw njesitw administrative Synej, Luz i Vogwl dhe Helmas.

Numri i punonjësve i nevojshëm në çdo rast, wshtw i bazuar në analizën qw i bashkangjitet DST.

2.3.7. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencat/lejet të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

1. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)
2. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërhyrëse higjeno-sanitare (kodi II.8.B)
3. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
4. Gjithashtu, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me:
 - a. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kod III.1 B për pastrim larje sprucim kontinieresh
ose
 - b. kontratë shërbimi për pastrim larje, sprucim kontiniereshme një subjekt tjetër i cili duhet të jetë i pajisur me Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kod III.1 B për pastrim larje sprucim kontinieresh.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura (“a” ose “b”) e bën ofertën të kualifikueshme.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të cilwt kryejnë shwrbimet objekt prokurimi dujet tw jenw tw pajisur me licencat dhe lejet e nevojshme nw mwnyrw qw tw realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara. Sistemi i menaxhimit të cilësië, të mjedisit dhe shëndeteti të sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto leje lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.3.8. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, 4 (katër) copë;
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 7 ton, 2 (dy) copë;
3. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 5 ton, 1 (një) copë;
4. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me dy fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, me sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, e pajisur me tub aspirimi të jashtëm thithës jo më pak se 2 (dy) copë;
5. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, 1 (një) copë;
6. Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 5000 litra ujë, 1 (një) copë;
7. Mjet pastrimi (gazelone) me kapacitet mbajtës 0,5-1.5 ton, me ngarkim fundor ose anësor , 1 (një) copë.
8. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më shume se 10 ton, 1 (një) copë; rezerve

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe foto perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe foto perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në formën e një deklaratë mjetet e mësipërme në të cilën të përcaktohet targat, lloji, numri i shasisë.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga operatorët ekonomikë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti 2.3.6, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar analizës teknike të cmimeve, e cila do të bashkëngjitet DST, sasia ditore e mbetjeve të gjeneruara është mesatarisht 42.1 ton/ditë në zonën e qytetit Kavajë dhe 16.2 ton/ditë në zonën e njësive administrative Synej, Luzi i Vogël dhe Helmas, në total 58.3 ton/ditë. Referuar kërkesës për mjete teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor totali i tonazhit të kërkuar është 4 mjete me kapacitet 10 ton, 2 mjete me kapacitet 7 ton dhe 1 mjet me kapacitet 5 ton, në total 59 ton. Bashkia Kavajë ka detyrimin që mbetet urbane mund të depozitohet në fillimin e Sharrës, i cili është rreth 50 km nga qyteti Kavajë. Kryerja e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, eferuar analizës dhe specifikimeve teknike, është nga ora 23:00 deri në orën 06:00 të ditës pasardhëse. Mësu nga kjo secili nga mjetet mund të bëjë vetëm një grumbullim transport në ditë.

Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve janë kërkuar dy, njëra për fshirjen e rrugëve të qytetit Kavajë dhe njëra për fshirjen e rrugëve të njësive administrative Synej, Luzi i Vogël dhe Helmas.

2.3.9. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën ambiente me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m² e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera. Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë. Në rastin kur ambienti merret me qira duhet të paraqitet kontratë e vlefshme qiraje dhe dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë e qiradhënësit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme i shërben operatorit ekonomik për parkimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës, larjen e tyre, magazinimin e kontenerëve dhe larjen e tyre. Gjithashtu kjo sipërfaqe do të shërbejë për riparimin e mjeteve kur ky shërbim do të kryhet nga vetë operatorit ekonomik.

2.3.10. Operatorët ekonomikë, për të garantuar realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të kenë apo mund t’i vihen në dispozicion 300 kazanë. Për të provuar këtë duhet të paraqitet:

a. dokumentacion i vlefshëm që vërteton disponimin e tyre.

b. kontrata e qerasë e vlefshme dhe e shoqëruar me dokumentacion justifikues të pronësisë së 300 kontinerëve të qiradhënësit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura (“a” ose “b”) e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor për disponueshmërinë apo furnizimin me materialet kryesore që nevojiten për realizimin e shërbimeve objekt i kontratës.

2.3.11. Operatorët ekonomikë, për të garantuar realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të kenë kontratë paraprake furnizimi/shërbimi për mirëmbajtjen e kazanëve. Për të provuar këtë duhet të paraqitet kontrata e furnizimi/shërbimi dhe certifikatën e cilësisë ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor për disponueshmërinë apo furnizimin me materialet kryesore që nevojiten për realizimin e shërbimeve objekt i kontratës.

2.4. Hartimi i analizës së kostos dhe specifikimeve teknike është bërë në bazë të VENDIM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.